



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
Drejtoria e Financës

Nr. .... Prot.

Tiranë, \_\_\_\_\_ 2013

**RAPORT MONITORIMI  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**(12-mujori Janar –Dhjetor 2013)**

Detajimi i buxhetit për vitin 2013 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2013-2015 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Detajim është realizuar sipas 6 programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, si dhe lidhjet midis politikave sektoriale dhe aktiviteteve nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program, të parashikuara në PBA për periudhën 2013-2013. Për dy mujorin Nëntor –Dhjetor 2013 në MAS është shtuar dhe programi i Sportit

**Ministria e Arsimit dhe Sporti për vitin 2013, administron dhe menaxhon fondet buxhetore, sipas gjashtë programeve të miratuara, të listuar me poshtë:**

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Mesëm Profesional dhe Social-kulturor”
5. Programi “Arsimi i Lartë”
6. Programi “Kërkimi shkencor”.
7. Programi “Për sportin”.

Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2013, fondet e **buxhetit të rishikuar** me aktin normativ nr. 6 tetor 2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.119/2012 datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, janë në shumën prej **38 miliard e 58.7** milion lekë. Fondet për arsimin , krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2013 arrijnë në **8.3%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2013 janë në nivelin **2.7%**.

Fondet “Për Arsimit”, ku janë përfshirë si pjesë e buxheti të arsimit, të ardhurat e universitete publike pa u përfshirë fondet për arsimin nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, si dhe Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme e tetjra institucione me fonde në shërbim të arsimit, Fondet “për arsimin , krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2013 arrijnë në **10.4%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto janë në nivelin **3%**.

**Fondet e miratuara për MAS së bashku me të ardhurat dytësore, sipas grup artikujve janë sa vijon;**

Fondet për shpenzimet korente ku përfshihen fonde për shpenzime personeli si dhe fondet për shpenzime për blerje materiale dhe shërbime arrijnë në kuotën 38 miliard 803 milion lekë ose 91 % të fondeve të miratuara për vitin 2013 dhe fonde për shpenzime kapitale janë 3 miliard e 687 milion lekë ose rreth 9 % e fondeve të realizuara në buxhetin të për vitin 2013

- a) **Fonde për shpenzime për personelin për vitin 2013;** janë planifikuar në shumën 34 miliard e 975 milion lekë, me një rritje e qëndrueshme e buxhetit me një rritje prej 3.5% ose 900 milion lekë më shumë se realizimi i vitit 2012 cila garantoj mbulimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të numrin aktual të

punonjësive të arsimit prej 38,901 punonjës ta arsimit prauniversitar si dhe rreth 5000 punonjës në IAL publike. Shpenzimet e personelit të miratuar për vitin 2013 zënë rreth **81.4%** e buxhetit të arsimit. Realizimi është në masën 34 miliard 584 milion lekë në masën 99%

- b) **Fondet për shpenzimet korente/operative për blerje mallra dhe shërbime;** Fondet e miratuar për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbime nga të tretë janë 4 miliard 307 milion lekë ose 10% e buxhetit të miratuar për vitin 2013. Zërat kryesorë në këtë grupatikull të shpenzimeve të tjera korrente janë, shpenzime për transportin e nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë, shpenzime për blerje mjete didaktike, shpenzime për shërbim interneti në shkolla, shpenzime për transfertat tek individët për blerjen e tekstet shkollore, shpenzime për bursat e nxënësve dhe studentëve, shpenzime për fondin e ekselencës etj, të cilat zënë edhe pjesën më të madhe të kësaj kategorie të shpenzimeve etj.

Realizimi i shpenzimeve në këtë grupatikull arrin në 4 miliard e 218 milion lekë ose në masën 98% e planit të rishikuar për vitin 2013.

**Fondet për shpenzime kapitale,** për vitin 2013 janë parashikuar në kutën 3 miliardë e 412 milion lekë ose rreth 8.8% e buxheti të miratuar për MAS, për vitin 2013. Pas rishikimit të buxhetit për vitin 2013, fondet për investime janë në masën 2 miliard e 826 milion lekë ose rreth 7.3% e fondeve të miratuara për vitin 2013, së bashku me të ardhurat e IAL publike fondet për investime kapitale arrijnë në 3 miliard e 687 milion lekë ose 8.8% e fonde të arsimit për vitin 2013.

Fondet për investime kapitale të klasifikuara sipas burimit të financimi për vitin 2013 janë 2.826 miliard lekë nga të cilat të financuara nga buxheti i shtetit janë 2 miliard e 472 milion lekë ose 87% e fondit të investimeve dhe fonde me financim të huaj janë 353.7 milion lekë ose 13% të fondit të investimeve i planifikuara për vitin 2013. Burimi i financimit të huaj janë Banka Botërore dhe Bankat Evropiane në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim”, si dhe financime të tjera nga Projekti IPA BE, KE Projekti CARDS, Qeveria Zvicerane, Qeveria Italiane.

Realizimi i shpenzimeve kapitale arrin në 2 miliard e 730.5 milion lekë ose në masën 97% e planit të rishikuar për vitin 2013.

Në total për vitin 2013 realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore është në masën 39 miliard 14 lekë ose 99% ndaj planit vjetor 2013, në analizë së bashku me të ardhurat dytësore të realizuara për periudhën 12-mujore arrijnë në 42 miliard e 476 milion lekë ose në masën 99%, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2013 arrijnë në **9.2%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto janë në nivelin **3.1%**.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grupatikujve për 12- mujin 2013 rezulton si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente	<b>99 %</b>
<u>Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale</u>	<u><b>98 %</b></u>
<b>Gjithsej</b>	<b>99 %</b>

**Tab\_1** Fondet buxhetore sipas grup artikujve të planifikuara për vitin 2013, **plani i rishikuar + te ardhurat dytësore** si dhe realizimi faktik për 12-mujorin në mijë lekë dhe në %.

Artikulli Kodi	Emri	PBA Plan 2013	Buxheti Fillestar 2013	*Buxheti i Rishikuar 2013	Realizimi 12- mujor 2013	Diferenca Realiz-Buxh rish 2013	Realizimi 12-mujor 2013 ne %
600-601	Paga+Sigurime Shoqërore	28,444,856	28,610,162	34,975,798	34,584,650	-391,148	99%
602-606	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6,364,650	6,914,822	4,307,250	4,218,439	-88,811	98%
<b>230-231</b>	Kapitale të Trupezuara Patrupëzuara	2,754,543	3,412,000	3,793,263	3,687,644	-105,619	97%
<b>Totali</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>37,564,049</b>	<b>38,936,984</b>	<b>43,076,310</b>	<b>42,490,733</b>	<b>-585,578</b>	<b>99%</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit konfirmuar nga Ministria e Financës.



**Tab\_1.1, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore për vitin 2013, si dhe realizimi per periudhën Janar – Dhjetor 2013,**

Nr	Emri i programit	Buxheti rishikuar 2013	Struktura		Realizimi 12-mujor 2013	
		(milion lekë)	Ne %	Në milion /lekë	Struktura ne % ndaj buxh total	Struktura e realizim ne% sipas program, ndaj totalit 2013
1	Planif. menaxhim administrim	699.5	1.8%	669.0	96%	1.8%
2	Arsimi baze	23,934.0	62.0%	23,588.9	99%	62.1%
3	Arsimi i mesem i pergjithshem	5,549.1	14.4%	5,493.5	99%	14.5%
4	Arsimi i mesem profesional	2,359.9	6.1%	2,274.2	96%	6.0%
5	Arsimi i larte	5,877.2	15.2%	5,833.1	99%	15.3%
6	Kerkimi shkencor	144.4	0.4%	140.9	98%	0.4%
7	Programi per Sportin	21.6	0.1%	14.4	67%	0.0%
<b>Totali</b>		<b>38,585.7</b>	<b>100.0%</b>	<b>38,014.0</b>	<b>99%</b>	<b>100.0%</b>



**Tab\_1.2, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore se bashku me te ardhurat për vitin 2013 si dhe realizimi per periudhën Janar- Dhjetor 2013,**

Nr	Emri i programit	Buxheti I Rishikua 2013 + Te ardhurat	Struktura		Realizimi 12- mujori 2013	
		(milion lekë)	Në %	Në milion /lekë	Struktura ne % ndaj buxh total	Struktura ne % ndaj realizim
1	Planif. menaxhim administrim	702.9	1.6%	672.5	96%	1.6%
2	Arsimi baze	23,947.7	55.6%	23,602.6	99%	55.5%
3	Arsimi i mesem i pergjithshem	5,549.1	12.9%	5,493.5	99%	12.9%
4	Arsimi i mesem profesional	2,359.9	5.5%	2,274.2	96%	5.4%
5	Arsimi i larte	10,077.6	23.4%	10,019.5	99%	23.6%
6	Kerkimi shkencor	417.4	1.0%	413.9	99%	1.0%
7	Programi per Sportin	21.6	0.1%	14.5	67%	0.0%
<b>Totali</b>		<b>43,076.3</b>	<b>100.0%</b>	<b>42,490.7</b>	<b>99%</b>	<b>100.0%</b>



**Tab\_2,** Struktura e buxheti 2012 sipas grup artikujve buxhetore në %;



**Tab\_3** Struktura e buxhetit të planifikuar për vitin 2013 sipas programeve buxhetore në %;



**Tab.4** Fondet buxhetore sipas grupartikujve të planifikuara për vitin 2013, (plani i rishikuara + te ardhurat dytesore) si dhe realizimi faktik për 12-mujorin sipas grupartikujve në mijë lekë dhe në %.



**Tab.4** Fondet buxhetore sipas grup artikujve të planifikuara në PBA 2013, (plani i rishikuara + te ardhurat dytesore) si dhe realizimi faktik për 12-mujorin në mijë lekë dhe në %.

Artikulli Kodi	Emri	PBA Plan 2013	Buxheti Fillestar 2013	*Buxheti i Rishikuar 2013	Realizimi 9-mujor 2013	Diferenca Realiz-Buxh rish 2013	Realizimi 9-mujor 2013 ne %
600-601	Paga+Sigurime Shoqërore	28,444,856	28,610,162	34,975,798	34,584,650	-391,148	99%
602-606	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6,364,650	6,914,822	4,307,250	4,218,439	-88,811	98%
<b>230-231</b>	Kapitale të Trupezuara Patrupëzuara	2,754,543	3,412,000	3,793,263	3,687,644	-105,619	97%
<b>Totali</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>37,564,049</b>	<b>38,936,984</b>	<b>43,076,310</b>	<b>42,490,733</b>	<b>-585,578</b>	<b>99%</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit konfirmuar nga Ministria e Financës.

**Tab.5. Plani I Shpenzimeve Kapitale per vitin 2013 si dhe realizimi i Shpenzimeve Kapitale per vitin 2013, sipas burimit të financimit ne lekë**

Plani I Shpenzimeve Kapitale per vitin 2013				Realizimi I Shpenzimeve Kapitale per vitin 2013					
Programi buxhetor	Nga Buxheti	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Financim I Brendshem Realizimi 2013 Financim nga Buxheti	Realizimi ne % ndaj planit 2013	Realizimi 2013 nga Financim Huaj	Financim I huaj Realizimi ne % ndaj planit 2013	Totali i Shp. Kapitale	Realizimi ne % ndaj planit 2013
1110	5,100	0	5,100	4,162	82%	0	0%	4,162	82%
9120	1,275,878	19,348	1,295,226	1,228,123	96%	19,348	100%	1,247,470	96%
9230	485,797	27,042	512,839	463,479	95%	27,042	100%	490,521	96%
9240	180,000	178,000	358,000	166,949	93%	178,000	100%	344,949	96%
9450	525,639	129,295	654,934	514,083	98%	129,295	100%	643,378	98%
9770	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Donatoret	Kontributi sipas donatoreve	Kontributi donatoreve %	Totali i fondeve te disbursuara deri ne 30.09.2013	% e disburimit, ndaj Kontributit total	Realizimi progresiv I shpenzimeve 2006-2012	Realizimi progresiv ne % 2006-2012	Plani Vjetor 2013	Realizimi shpenzimeve per vitin 2013-9	% e realizimit 2013	Realizimi progresiv I shpenzimeve 2006-2013	Realizimi progresiv ne % 2006-2013	Diferenca e Kredise e pa disbursuar	Diferenca e Kredise e padisbursuar
A		B		C		D		F=C+D		G=A-B			
<b>BB</b>	11,832,629	20%	11,149,860	94%	<b>10,439,196</b>	67%	<b>710,664</b>	<b>330,884</b>	47%	<b>10,770,080</b>	91%	1,062,529	6%
<b>BEI</b>	12,500,000	21%	10,567,086	85%	<b>10,567,086</b>	60%	<b>0</b>	<b>0</b>	0	<b>10,567,086</b>	84.5%	1,932,914	15%
<b>CEB</b>	14,000,000	23%	11,320,000	81%	<b>11,320,000</b>	48%	<b>0</b>	<b>0</b>	0	<b>11,320,000</b>	80.9%	2,680,000	19%
<b>GoA</b>	22,066,667	37%	17,708,250	80%	<b>15,239,094</b>	80%	<b>2,476,789</b>	<b>2,455,122</b>	90%	<b>17,694,216</b>	80.0%	4,372,451	20%
<b>Total</b>	<b>60,399,296</b>	100%	<b>50,745,196</b>	84%	<b>47,565,376</b>	79%	<b>3,187,453</b>	<b>2,786,006</b>	83.4%	<b>50,351,382</b>	83.4%	-	16.6%
												10,047,894	

Në mënyrë më analitike sipas gjashtë programeve buxhetore, realizimi i fondeve të buxhetit dhe produkteve të parashikuara për periudhën 12- mujore 2013, paraqitet sa vijon;

### I – Programi buxhetor PLANIFIKIM-MENAXHIM. (Titulli i programit 0111 )

Fondet e miratuara për këtë program janë **699.4 milion dhe zë rreth 1.8%** të buxhetit të MAS. Realizimi për periudhën 12- mujore është **669 milion lekë** në këtë program në masëm **96%** ndaj planit vjetor ose **1.8%** të fondeve të realizuara për periudhën 12-mujore në totalin e fondeve të realizuara të MAS për vitin 2013

#### Objektivat kryesore:

1. Forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese me 20% të punonjësve në MAS, DAR dhe ZA.(për 130 punonjës). Përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimore.
2. Përmirësimi i kushteve të punës, për rritjen e eficensës dhe efektivitetit në punë, nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë (materiale, energji, internet, telefon ngrohje etj), si dhe rinovimit të paisjeve e aseteve të qëndrueshme me 5-10% në vit, pajisjeve të zyrave, pajisje teknologjike, rikonstrukcionin/zgjerimit e objekteve ekzistuese, si dhe ndërtimeve të reja.
3. Zhvillimi i sistemit të informacionit EMIS në përputhje me standardet operacionale në arsim, nëpërmjet shtrirjes dhe funksionimit të sistemit EMIS në të gjithë DAR/ZA. Publikimi për çdo vit shkollor i raportit të arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar
4. Vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent monitorimi, në planifikimin dhe përdorim e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim Përfrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE (acquis communautaire).
5. Rritja e aftësive vlerësuese dhe vetëvlerësuese në sistem, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent monitorimi, në planifikimin dhe përdorim e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim.Auditimi dhe inspektimi i 30% të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.
6. Trajnimi i **80 drejtuesve** të shkollave për realizimin e autonomisë shkollore në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor, si dhe rritjes të autonomisë së shkollave duke fuqizuar kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese në shkollë.

#### Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2013 janë 694.3 milion lekë

- a) Fondet për “Pagat dhe sigurimet shoqërore, artikulli 600-601”; *shpenzime personeli* që arrijnë nga 561.2 milion lekë në vitin 2013, realizimi për periudhën 12-mujore është në masën 96%, me një rritje mesatare vjetore prej 3% në vit.
- b) *Fondet për shpenzime personeli për vitin 2013 kanë mbuluar pagat si dhe sigurimet shoqërore* për 656 punonjës nga të cilët;
  - ✓ Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 116 punonjës,

- ✓ Drejtoritë Arsimore Rajonale, 13 drejtori me 270 punonjës e specialistë
- ✓ Zyrat Arsimore në Rrethe, 25 zyra me 240 punonjës e specialistë;
- ✓ Inspektoriati Kombëtar i Arsimit, me 30 punonjës

- c) **Fonde për krijimin e kushteve të punës** për rreth 656 punonjës në Aparatin e MAS si dhe DAR/ZA për vitin 2013 janë planifikuar **120 milion lekë** në vit ku sipas përparësive janë parashikuar; Fonde për të mbuluar shpenzimet për energji elektrike, telefon, internet, ujë, karburant, udhëtime e dieta, kancelari, materiale të tjera zyre, si dhe likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Shpenzime për trajnimin e punonjësve të MAS, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve etj. Në këtë program është mbajtur paraysh në detajimin e buxheti për vitin 2013 dhe fondet për internet për 38 institucione DAR/ZA dhe Aparati i MAS.

**Fondet për shpenzime kapitale** për vitin 2013 sipas planit të rishikuar arritën në masën **5.1 milion lekë**, me synim kryesor rritjen e infrastrukturës dhe kapaciteteve menaxhuese. Burimi tyre është financim nga buxheti i shtetit 5.1 milion lekë, si dhe financim i huaj 0 milion lekë. Në këtë program realizimi i shpenzimeve kapitale për 12 mujin 2013 vetëm 82.3%.

#### Sipas projekteve kryesore paraqiten:

- ✓ Blerje pajisje elektronike dhe softë për DAR/ZA dhe MAS, në kuadër të projektit "Cilësi dhe barazi në arsim", plani u rishikua në 0 lekë.
- ✓ Rehabilitime të mjediseve të MAS dhe zyrave DAR Vlore në vlerë **3.3 milion lekë, realizuar 3.002 milion lekë ose 91%**.
- ✓ Pajisje për DAR/ZA dhe MAS në shumën **1.78 milion lekë, realizuar 1.16 mijë lekë ose 65%**.

#### Disa nga produktet/aktivitete e realizuara për periudhën për vitin 2013

**Inspektimi;** gjatë vitit 2013 janë realizuar gjithsej **410 inspektime për të tri llojet;**

- ✓ **4 Inspektime të plota**<sup>1</sup> (3 shkolla dhe një kopsht)
- ✓ **222 Inspektime tematike**<sup>2</sup> (13 shkolla për mësimdhënien dhe të nxënë, 35 gjimnaze dhe 174 kopshte për sigurinë dhe mjediset fizike)
- ✓ **184 Inspektime të orientuara**<sup>3</sup> (10 DAR/ZA për mësuesit e licensuar, 27 shkolla jopublike për zbatimin e ligjshmërisë, 13 shkolla për funksionimin e laboratorëve, 7 shkolla për provimet e lirimt dhe të maturës, 110 kopshte dhe institucione të palicensuara, 17 zgjidhje ankimimesh)

**Auditimi;** për vitin 2013 janë realizuar

- ✓ 14 auditime të plota nga 23 të planifikuara
- ✓ 25 auditime të përputhshmërisë nga 27 të planifikuara,
- ✓ 9 auditime tematike universitete për procedurat e doktoraturave të pa planifikuara në programin vjetor,
- ✓ 3 auditime investikative (Me kërkesë të menaxhimit të Lartë).

**Spektori i e-Edukimit&e-Learning, ka realizuar këto detyra:**

<sup>1</sup> **Inspektimi i plotë** nënkupton vlerësimin tërësor të shkollës apo të DAR/ZA-së duke u bazuar në standardet përkatëse të Udhëzuesve zyrtarë të inspektimit të shkollës dhe DAR/ZA-ve. Ky është një inspektim jo i shpeshtë që mbështetet thellë në raportin e vetëvlerësimit që ka bërë institucioni arsimor. Ky lloj inspektimi varion nga 3-5 ditë.

<sup>2</sup> **Inspektimi tematik** është i planifikuar për fusha të ndryshme të funksionimit të shkollës apo DAR/ZA-të, të cilat konsiderohen prioritete nga politika arsimore dhe është e domosdoshme që të ketë monitorime, kontrole dhe vlerësime nga ekupe inspektimi të specializuara. Edhe ky lloj inspektimi zë vend dhe është i shpeshtë në punën e ISHA. Ky inspektim mund të shkojë deri në 2 ditë.

<sup>3</sup> **Inspektimi i orientuar** ka të bëjë me kontrollin, monitorimin apo vlerësimin e drejtimeve të veçanta të shkollës apo të drejtimeve që ISHA merr detyrë nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit. Ky është lloji i inspektimit më shumë i përdorur, i cili varion nga 1-2 ditë. Ai mund të jetë dhe i paplanifikuar.

1. Trajnimi në nivel shkolle i përdorimit të sistemit të menaxhimit të informacionit në sistemin arsimor parauniversitar (SMIP);sa jane trajnuar **2** punonjes **per çdo DAR/ZA gjithesej 72 punonjës**
2. Konfigurimi i sistemit nga AKP në bashkëpunim me kompaninë BIT për vazhdimin e trajnimit; jane trajnuar **2 punonjes se AKP-se**
3. Pjesmarje në konferenca/ëorkshope me objektin "TIK në arsim"; Konferenca "Zhvillimi i e-edukimit në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes në praktikat ndërkombëtare më të mira"; jane trajnuar **5** punonjes (**stafi i drejtorise**)

Realizimi i fondeve për periudhën 12- mujore Janar -Dhjetor 2013, në këtë program është në masën 96% dhe përfaqëson rreth 1.8% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore.

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente	<b>96 %</b>
<u>Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale</u>	<b>82%</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>96 %</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelën:

Kodi i Prod	Emri i Produktit	Buxhet Plan 2013	Buxheti Rishikuar 2013	Fakti 12- mujor 2013	Realiz ne % ndaj planit vjetor 2013
A	Forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese projektit "Cilesi dhe Barazi"	2,084.2	2,084.2	2,084.2	100%
B	Krijimi i kushteve te punes per punonjesit ne MASH,DAR/ZA dhe inspektoriati Kombetar i AP.	71,050.0	71,050.0	<b>114,070</b>	161%
C	Trajnimit te punonjesve ne MASH, DAR/ZA/Inspektoriat per ritjen e kapaciteteve te burimeve njerezore.	6,000.0	6,000.0	4,300	72%
D	Krijimi i sistemit te Monitorimit, Trajnimi i punonjesve te MASH, DAR/ZA ne kuader te sistemit EMIS.	2,000.0	2,000.0	<b>0</b>	0%
E	Vleresimi i punes se punonjesve ne MASH,DAR/ZA.	606,228.0	597,220.4	536,856	90%
F	Trajnimi i drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimit i shërbimit arsimor	6,000.0	6,000.0	3,392	57%
M	Auditimi dhe inspektimi institucioneve te Sistemit te Arsimit	10,000.0	10,000.0	4,164	42%
H	Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike per sherbimet ne MASH,DAR/ZA	42,400.0	0.0	0	0%
I	Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne MASH, DAR/ZA	5,811.5	3,311.5	3,002	<b>91%</b>
K	Blerja e softeve informatike per sherbimet ne MASH,DAR/ZA	37,000.0	0.0	0	<b>0%</b>
L	Blerja e pajisjeve e mobileri zyre per krijimin e kushteve te punes ne MASH,DAR/ZA	1,788.5	1,788.5	1,159	<b>65%</b>
				0	
	<b>TOTALI</b>	<b>790,362.2</b>	<b>699,454.6</b>	<b>669,027.3</b>	96%
	<b>Shpenzime jashte buxhetore</b>		<b>3,423.2</b>	<b>3,423.2</b>	100%
	<b>Totali</b>	<b>790,362.2</b>	702,877.8	672,450.4	96%

#### Disa nga aktivitetet që nuk janë realizuar ;

1. Krijimi i sistemit te Monitorimit, Trajnimi i punonjesve te MAS, DAR/ZA në kuadër të sistemit EMIS, procedurat e prokurimit nuk u finalizuan me sukses, fondet u rishikuan.
1. Trajnimi i drejtorëve të shkollës si administratorë të institucioneve arsimore.
2. Blerje pajisje informatike dhe elektronike për sistem EMIS në MAS dhe DAR/ZA (CBA), procedurat e prokurimit nuk u finalizuan me sukses.

#### Faktorë që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për vitin 2013;

3. Fondet në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme në buxhetin e MASH, për këtë program mbetën në kapitullin 03, nuk janë alokuar për arsye të përmbushjes së detyrimeve me akt normativ në fund të vitit 2013, ndërsa për një pjesë të vogël të detajuar procedurat e prokurimit nuk u finalizuan me sukses.
4. Gjithashtu fondi prej 2.5 milion lekë i planifikuar për nisjen e projektit për rikonstruksion të ambjenteve të MAS, ishte “fond i ngrirë” nga Ministria e Financave

## II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)

Fondet e miratuara për këtë program për vitin 2013 janë 23.9 miliard, buxheti i programit të arsimit të 9 vjeçar rreth 55.5 %, realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore është në masën 23.6 miliard lekë ose në 99% e fondeve të planifikuara të programit. Në strukturën totale buxheti i arsimit bazë pa u përfshirë shpenzimet e njësisë të qeverisjes vendore arrin në 5.84% ndaj shpenzimeve publike, ose 1.7% të PBB.

Buxheti i arsimit bazë përfaqëson rreth 55.5% të totalit të shpenzimeve të realizuara për arsimin.

### **Objektivat kryesore :**

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies si dhe duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

**Objektiv 1).** Rritje e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 5% në klasat përgatitore me 1500 fëmijë më shumë. Modernizimi i arsimit parashkollor, përmes trajnimit të mësuesve (15-20% në vit), rikonstruksionit dhe ndërtimit (150 -200 klasa në vit) të kopshteve dhe pajisjes me bazë materiale didaktike

**Objektiv 2).** Hartimi i kurrikulës lëndore (kl 0 - 6), përgatitja e 60 moduleve trajnuese për kurrikulën e rishikuar, të 10 moduleve për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK). Trajnimi i mësuesve të AB për zbatimin cilësor të kurrikulës 25 % e mësuesve të AB. Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore dhe kompensimi 100% për nxënësit rom, egjiptiane, fëmijëve të familjeve në nevojë 4 000 nxënësve

**Objektiv 3).** Sigurimi i një arsimit cilësor për fëmijët në nevojë, (rritja e treguesit të regjistrimit me 4.5% ose 160 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me AK. Rritja me 1.5 % e numrit të mësuesve asistent për nxënësit me AK. Sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e AB. Uljen e braktisjes shkollore në AB nën 0.3%. Trajtimi i diferencuar i mësuesve (20-25%) që, do të punojnë me fëmijët që kanë braktisur shkollën për riintegrimin e tyre.

**Objektiv 4).** Konsolidimi i shërbimit psikologjik nëpërmjet tranimit të mëtejshëm të psikologëve (250) dhe modernizimit të kabineteve përkatëse

**Objektiv 5).** Arsimit cilësor e gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane: ndërtime të reja e rihabilitim të objekteve arsimore 450 - 500 klasa e sigurimi i pajisjes së tyre. Pajisja e 20-25% të shkollave të AB me laborator shkencorë, IT synimi një kompjuter për dy nxënës në orë mësimi, laboratorë virtual e biblioteka dixhitale në AB (të paktën 1 set laptop-projektor për çdo shkollë

Për vitin 2013 në zërin e **shpenzimeve për personelin** janë miratuar 21 miliard e 741 milion lekë për mbulimin pagave dhe të sigurimeve shoqërore për rreth **30,173 punonjësve të arsimit 9-vjeçar** nga të cilët 29 894 punonjës mësimorë e ndihmës për shërbime mbështetëse, për rreth 356 347 nxënësve në arsimin 9-vjeçar dhe rreth 76 416 fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor. Shpenzimet për shpenzime personeli për periudhën 12-mujore janë realizuar në masën **99 %** ndaj planit 2013 ose **21 miliard 440 milion lekë** lekë.

**Për vitin 2013 në prorgmin e arsimit bazë u siguruan kushte për kryerjen e praktikës profesionale për rreth 1200 praktikantë konform VKM nr.23, datë 9.1.2013** “Për përcaktimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhat 1 janar - 15 qershor 2013 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2013, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës”

**Fonde buxhetore për krijimin e kushteve të punës** të planifikuara për vitin 2013 në artikullin buxhetor (602-606) për mësimdhënie në arsimin parashkollor për afro 76 416 fëmijë dhe 356 347 nxënës arsimin 9-të vjeçar, për trajnimin e punonjësve mësimorë të arsimit 9-të vjeçar janë parashikua **919.8 milion lekë**

a) **Fondet për mbulimin e shpenzimeve të transportit** “Për transportin 31 197 nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 11 128 mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë”, janë planifikuar detajuar 523 milion lekë mbështetur në të dhënat analitike të dërguar nga për cdo DAR/Za, si dhe analizën aktuale të cdo institucioni, për këtë periudhë janë realizuar 523 milion lekë. Theksojmë se për të mbuluar detyrimet vjetore sipas VKM për këtë shërbim në programin e arsimit bazë kërkohet dhe një shumë prej 150 milion lekë (duke pasur parasysh detyrimet e trashëguara 2012 në vitin 2013),

b) **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet e bursave** për 322 nxënës romë dhe egjiptianë me afro 2.2 milion lekë në vit.



- c) **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet për institucionet special** për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe nxënësit nuk shikojnë për rreth 220 nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë me afro 21 milion lekë në vit.
- d) **Fonde për shërbimin e internetin në shkollat e arsimit 9-vjecar ,vetëm për periudhën** pas përfundimit të kontratës me Albtelekom si dhe përcaktimit të numrit të shkollave që nuk do të përfitojnë internet nga “Posta Shqiptare”.
- e) Shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR, që punojnë me nxënës nga shtresat e marxhinalizuara, si dhe uljen e braktisjes **8.6 milion lekë**;
- f) Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor DAR/ZA, **janë realizuar 10 milion lekë**,
- g) Shpenzime për Vlerësimi i teksteve shkollore si dhe veprimtaria e KMT 2013 librit shkollor – honorare vlerësimi, komisioni i vlerësimit, shërbime hotelerie vlerësuesve **3.5 milion lekë**.
- h) Shpenzime për blerje pulla me hologram **janë parashikuar 4 milion lekë**.
- i) **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet për transfertat tek individët për blerjen e tekstet shkollore**, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar vendimin nr. 212 datë 16.3.2011 si dhe shperblime nga fondi i vecante për raste ndihme hospitalore si dhe raste vdekje në familje. janë planifikuar dhe realizuar rreth 245 milion lekë, për rreth 93 756 nxënës përfitues nga shtresat sociale në nevojë, tekstet për nxënës në diasporë, nga të cilët 3 063 nxënës romë, si dhe për nxënësit që nuk shikojnë, duke përfshirë dhe rimbursimin e teksteve të minoriteteve.

Zëri i *shpenzime operative* (artikulli 602-606), janë planifikuar 888 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 499 milion lekë ose në masën 56.2%, nga të cilat:

#### ***Për kualifikimin e mësuesve në vitin 2013***

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat lidhur me numrin e mësuesve të regjistruar për t’u kualifikuar për vitin 2013 dhe atyre që u paraqitën ditën e testimit:

Nr	DAR	Nr. i pjesëmarrësve të regjistruar	Nr. i pjesëmarrësve që u paraqitën	Munguan
1	BERAT	250	245	5
2	DIBËR	181	178	3
3	DURRËS	341	334	7
4	ELBASAN	459	449	10
5	FIER	577	564	13
6	GJIROKASTËR	162	157	5
7	KORÇË	361	359	2
8	KUKËS	151	146	5
9	LEZHË	170	169	1
10	SHKODËR	351	343	8
11	TR. QYTET	357	352	5
12	TR. QARK	346	343	3
13	VLORË	209	204	5
<b>Totali</b>		<b>3915</b>	<b>3843</b>	<b>72</b>

#### ***Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve***

Rezultatet përfundimtare u përcollën në MAS, duke mundur me tej mundësinë e gradimit dhe shtesës së pagës për të gjithë mësuesit që kanë kaluar kualifikimin në secilën DAR/ZA.

#### ***Arritje të mësuesve sipas shkallëve të kualifikimit***

Shkalla e kualifikimit	Portofoli shkollor	Arritja mesatare në test	Performanca e përgjithshme
Kategoria e parë	47.47%	69.25%	67.22%
Kategoria e dytë	13.85%	66.98%	65.19%
Kategoria e tretë	13.83%	63%	62.30%
<b>Gjithsej</b>	<b>13.94%</b>	<b>65,76%</b>	<b>64.40%</b>

#### ***Shpërndarja e mësuesve të çdo cikli sipas shkallëve të vlerësimit në %***

Cikli	A	B	C	D	E
-------	---	---	---	---	---

Arsim parashkollor	0.22%	15.92%	68.39%	10.99%	4.49%
Cikli fillor	0.95%	29.60%	58.82%	8.43%	2.21%
Arsimi i mesëm i ulët	2.27%	34.46%	50.13%	9.30%	3.04%
Arsimi i mesëm i lartë	6.53%	38.55%	45%	6.73%	3.16%
Arsimi profesional	2.50%	30%	62.50%	2.58%	2.50%
Arsimi social-kulturor	7.80%	28.95%	47.37%	13.16%	2.64%
Arsimi special	12.50%	75%	12.50%		
<b>Gjithsej</b>	<b>2.57%</b>	<b>31.75%</b>	<b>53.66%</b>	<b>8.72%</b>	<b>3.32%</b>

Në procesin e kualifikimit në vitin 2013, grupi më i madh i mësuesve të përfshirë në kualifikim është ai i vlerësuar *Mirë* 53.66 % dhe *Shumë mirë* 31.75 %. Pra, rreth 86% e grupit mësuesve të vlerësuar për të marrë shkallën e kualifikimit për vitin 2013 janë të nivelit *Mirë* dhe *Shumë mirë*.

**Gjatë vitit 2013 u hartuan gjithsej 39 programe orientuese**, nga të cilat 2 programe për provimet e detyrueshme (Gjuhë shqipe dhe letërsi dhe Matematikë) dhe 37 programe për provimet me zgjedhje. Programet orientuese për provimet me zgjedhje përmbajnë të integruara programet e lëndëve bërthamë dhe programet e lëndëve të thelluara.

**Gjithashtu u përgatitën 37 programe lëndore të ndara sipas katër grupeve**

Programe për fëmijët e ngjuar (klasat I - V)

Programe për fëmijët e ngjuar (klasat VI - IX)

Programe për klasat e shansit të dytë (klasat I - V)

Programe për klasat e shansit të dytë (klasat VI - IX)

**Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimit Bazë, janë 1 miliard e 295 milion** lekë nga të cilat :

- 1.249 miliard lekë** financim i brendshëm ose **96.5%**
- 46 milion lekë** me burim financim të huaj ose **3.5%**

**Sipas projekteve kryesore paraqiten:**

✚ **Investime pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve 2012-2013** në shumën prej rreth **985 milion lekë** për objektet në vazhdim dhe objekte të reja të miratuara me FZHR 2013

- U financuan 50 objekte ndërtim të reja me vlerë rreth 289 milion lekë realizuar rreth 260 milion lekë ose 90%,
- U financuan 87 rikonstruksione objektesh arsimore me vlere rreth 563 milion lekë realizuar 560.5 milion lekë ose 99%,
- U financuan 86.4 milion lekë për pajisje mobilerie të realizuara 86.4 milion lekë ose 100%.

✚ **Investime në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim** me vlerë financimi gjithsej 276.1 milion lekë.

- Ndërtim të reja 6 objekte shkollore në vazhdim nga viti 2012 në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë financimi 206.6 milion lekë, realizimi 205.6 milion lekë.
- Rehabilitime në kuadrin e projektit "Cilësi e barazi në arsim" për 2 projekte në vazhdim nga viti 2012 me vlerë 4.9 milion lekë, realizuar 4.85 milion leke.
- Pajisje mobilje për 3 shkollat e reja në vazhdim nga viti 2012, në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë prej 16.4 milion lekë, realizuar 16.4 milion leke.
- Pajisje kompjuterike – 14.9 milion lekë në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim, realizuar 3 milion leke.
- Kabinete informatike të pajisura me lidhje interneti - 14.5 milion lekë, nuk ka realizim.
- Studim projektim 2.1 milion leke, realizuar 100%
- Pajisje laboratorike kimie, fizike, biologji – 16.5 milion lekë realizuar 100% .
- Tvsh dhe kosto lokale për projektet e Bashkise se Tiranes – 28.9 milion lekë, realizuar rreth 24.1 milion leke .
- Tvsh e financuar për projektet e PNUD-it, (4 rikonstruksione shkollash 9-vjecare dhe 1 ndertim i ri) – 24.2 milion lekë, realizuar 100% .

**Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12 mujorin 2013** në këtë program është 1 miliard e 247 milion lekë ose 96 % të buxhetit të planifikuar. Në total realizimi i fondeve për 12- mujorin 2013 në këtë program është në masën 99% dhe përfaqëson rreth 59.6% të fondeve të arsimit të realizuara të fondeve të MAS.

Shpenzimet korente	99 %
<u>Shpenzimet kapitale</u>	<u>96 %</u>
<b>Gjithsej</b>	<b>99 %</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet ne tabelën ne vijim

		Në mijë lekë			
Kodi i		Buxheti Vjetor 2013	Buxheti Rishikuar 2013	Fakti 12- mujor 2013	Realiz ne %
Produktit	Emri i Produktit				
A	Krijimi i kabineteve te psikologeve, furnizim me pajisje e orendi	10,000.0	10,000.0	10,000.0	100%
A	Furnizimi me pajisje mobilierie i shkollave dhe kopshteve te reja dhe te rehabilituara	16,410.0	76,409.7	76,401.0	100%
A	Rikonstrukcion I shkollave ne arsimin baze	673,725.0	568,180.7	565,246.8	99%
A	Laboratorë kimie, fizike, biologjie të pajisur dhe funksionalë	16,500.0	16,500.0	16,500.0	100%
A	Ndertimi i kopshteve te reja	42,614.0	58,530.9	57,904.8	99%
A	Rehabilitimi i kopshteve per rritjen e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë	0.0	9,896.4	7,896.4	80%
I	Ndertimi i shkollave te reja ne arsimin baze	302,674.5	495,271.4	464,218.4	94%
J	Instalim dhe furnizim me internet ne shkolla	87,060.0	20,000.0	20,000.0	100%
K	Kosto Lokale , Projekti i keshillit te europër ne Bashkine e Tiranës	28,900.0	28,900.0	24,086.6	83%
L	Studime projektme per shkollat e reja	2,135.4	2,135.4	2,135.4	100%
B	Blerje pajisje informatike per krijim laboratore IT	14,981.6	9,401.0	3,081.6	33%
C	Sherbimit arsimor ne sistemin PARASHKOLLOR , per permbushjen e funksioneve te edukimit dhe realizimin e m	3,657,485.0	3,657,485.0	3,620,910	99%
A	Realizimi i sherbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçar, per permbushjen e funksioneve te edukimit dhe realizimin e misionit te arsimit.	18,025,453.0	18,007,637.0	17,760,885	99%
D	Pergatitja e teksteve shkollore, si dhe kompesimi inxenesve te shtresat sociale ne nevojë, si dhe trajtime/shperblime te punonjesve nga Fondi vecante	246,000.0	283,545.2	<b>277,289</b>	98%
E	Sherbim transporti per nxenes dhe mesues. Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportimin e mësuesve qe punojne mbi 5 km nga vend banimi i tyre dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë mbi 2km jashtë vendbanimit.	523,000.0	523,000.0	523,000.0	100%
F	Trajnimi i mësuesve te arsimit baze,perdormin laboratore shkencore, perzhvillimin e kompetencave profesionale si dhe implementimin e kurikulave te reja apo ngritjen profesionale te tyre.	11,465.0	11,465.0	8,565.0	75%
G	Realizimi i sherbimit arsimor per nxenes me kerkesa te vecanta.	117,753.0	121,377.2	118,374.4	98%
	Hartimi i komizës kurrikulare të AB (k11-9), Kurrikula të rishikuara dhe të rivlerësuar të Arsimit të Bazë.	35,631.0	34,262.7	32,390.4	95%
		<b>23,811,787.4</b>	<b>23,933,997.6</b>	<b>23,588,884.5</b>	99%
	<b>Shpenzime jashte buxhetore</b>	-	<b>13,733</b>	<b>13,733</b>	100%
	<b>TOTALI</b>	<b>23,824,797</b>	<b>23,947,730</b>	<b>23,602,617</b>	99%

### Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar për 12-mujorit 2013;

1. Instalim dhe furnizim me internet ne Shkolla, nuk janë realizuar me sukses procedurat sipas kontratës.
2. Blerje pajisje kompjuterike per kabinetet e informatikës me fonde në kuadër të projektit **Cilësi dhe Barazi në Arsim**; nuk janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit.

### Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12 mujorin 2013:

1. Nga Fondi për zhvillimin e rajoneve nuk janë realizuar vetëm ato fonde që janë duke u kryer procedurat e prokurimit, për objektet e celura në 2013.
2. Në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, nuk u realizuan fondet kryesisht për internetin si pasojë e mangësive në dokumentacionin e paraqitur nga firma kontraktore, si dhe mosrealizimi me sukses i procedurave të prokurimit për pajisje kompjuterike.
3. Kufizime buxhetore nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për mungesë të limitit mujor të shpenzimeve në finacimine punimeve/ kontratave.

### III - ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM. (Titulli i programit 09230)

Buxheti i rishikuar për program e arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2013 është në vlerën **5 miliard e 549 milion lekë me 14.4%** të buxhetit të MAS. Realizimi i shpenzimeve për 12- mujorin 2013 në këtë program është në masën **4 miliard e 493 milion lekë** ose në masën 99 % dhe përfaqëson rreth 14.2 % të fondeve të realizuara për MAS.

#### **Objektivat kryesore:**

- ✓ **Objektiv 1).** Rritja e mëtejshme e cilësisë së mësimdhënies, me qëllim që, deri në vitin 2015 të përafrohemi me standardet e vendeve të BE . Pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat. Shtimi i laboratorëve të TIK si dhe shtrirja në vazhdim e internetit në shkollat e arsimit të mesëm të mesëm të përgjithshëm. Pajisja me laboratorë virtuale e rreth 15% të shkollave të mesme të përgjithshme për çdo vit.
- ✓ **Objektiv 2).** AMP ta ndjekin 78% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, ndërsa 22% ndjekin arsimin profesional. Përmirësimi i standardeve të infrastrukturës në gjimnaze, 8-10% e klasave ndaj totalit ekzistues do të rehabilitohen, 5%-8% e klasave ndërtohen te reja, 8-10 % e shkollave do të pajisen me laborator shkencor (CBA).Pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat.
- ✓ **Objektiv 3).** Trajnimi i 15-20% e punonjësve mësimore, për zbatimin kurikulës së gjimnazit, si dhe 50 mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kultures shqipe në diasporë. Ndjekja e praktikave profesionale nga 500 mësues të sapo diplomuar .
- ✓ **Objektiv 4).** Krijimi i kushteve për realizimin e matures shtetërore, realizimi i testeve për provimeve, procesi i dhënies së provimeve, korigjimeve, rikorrigjimet deri në shpallejen e rezultateve. Vlerësimi i nxënësve, dhe shpallja e rezultateve sipas standardit “meritë preferencë”, si dhe realizimi i Provimeve të shtetit.

#### **Arritje 2013**

- ✓ Në vitin shkollor 2012/13, rreth 92% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar u regjistruan në arsimin e mesëm, çka tregon se objektivi i kësaj qeverie, sipas të cilit çdo nxënës që përfundon arsimin e detyruar duhet të ketë mundësi reale për të vijuar arsimin e mesëm, është realist dhe në rrugë të mbarë të realizimit të tij
- ✓ Për vitin 2013 **arsimin e mesëm të përgjithshëm** u siguruan kushte dhe shërbim arsimorë për rreth 111 086 nxënës.
- ✓ **Në arsimin e mesëm të përgjithshëm**, vazhdon konsolidimi i cilësisë së Maturës Shtetërore, e cila konsiston në 4 provime për rreth 42 - 45 mijë maturantë (2 provime të detyruara dhe 2 provime me zgjedhje).
- ✓ Për nxënësit që përfunduan me sukses Maturën Shtetërore gjatë vitit 2013 u pajisen me diplomë të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP); çdo diplomë përmban të njëjtin numër identifikues ID të nxënësit, që ka dhënë provimin e Maturës Shtetërore, dhe që regjistrohet në sistemin e të dhënave pranë AKP-së. Ky është një standard i ri cilësor që e përafrohet shumë Maturën Shqiptare me atë të vendeve të tjera, rrit cilësinë e studentëve në hyrje, për pranim në shkollën e lartë, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së studimeve universitare dhe lehtëson pranimin e studentëve shqiptarë në shkollat e larta të huaja dhe mobilitetin e studentëve në tërësi.
- ✓ Në kurrikulën e arsimit të mesëm të përgjithshëm është shtuar si lëndë me zgjedhje këtë vit, lëndë “Financat Personale”, e cila realizohet në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Shqipërisë që ofron ekspertizën dhe trajnon mësuesit përkatës në shkollat e mesme. Është aktualisht në proces përgatitja e programit modular për lëndën e Sipërmarrjes përfshirë në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm, në funksion të përgatitjes për tregun e punës.
- ✓ **Rreth 80 mësues dhe pedagogë, nga më të mirët e vendit**, punuan me përkushtim dhe përgjegjësi në përbërje të grupeve të programeve lëndore dhe grupit qendror për hartimi i kurrikulës së re të arsimit 9-vjeçar, e cila mbështetet në traditën e arsimit tonë kombëtar dhe në përvojën e vendeve më të suksesshme në arsim. Kjo paketë është në fazën e diskutimit përfundimtar dhe së shpejti miratohet.

- ✓ **Gjatë periudhës Janar-Shtator 2013, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP)** organizoi Provimin e Shtetit për degët Mjekësi dhe Farmaci e etj, nëpërmjet teknologjisë dixhitale dhe në përputhje me standartet evropiane. Sesi i parë i provimit të shtetit përfundoi me sukses të plotë dhe fitoi një besueshmëri të lartë tek publiku. Për herë të parë në Shqipëri u zhvillua dhe implementua një standard i mirëfilltë ndërkombëtar i provimit tërësisht dixhital, me zero korrupsion dhe transparencë maksimale.
- ✓ **Për vitin 20123 në programin arsimit të mesëm, u siguruan kushte për kryerjen e praktikës profesionale për rreth 300 praktikantë konform VKM nr.23, datë 9.1.2013** “Për përcaktimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhat 1 janar - 15 qershor 2013 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2013, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës”. Rregullorja mbi “Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit” Nr. 3874, datë 14.07.2011 **miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit si dhe programi i praktikës profesionale për mësuesit e rinj**, të cilët do t’i nënshtrohen provimit të shtetit, në mënyrë që të kualifikohen si mësues të licencuar. Sipas kësaj Rregulloreje, mësuesit e diplomuar në shkollat tona të larta do të mundën ta ushtrojnë profesionin e mësuesit vetëm pasi t’i nënshtrohen praktikës profesionale njëvjeçare të cilët janë mësues që përmbushin kritere të caktuara, dhe pasi t’i jenë nënshtuar provimit të shtetit.
- ✓ **Sfida kryesore në arsimin e mesëm të përgjithshëm vazhdon të mbetet cilësia me standarte bashkohore** teknologjike dhe përafrimi i kurrikulës së klasës 10-12 në përputhje me tregun e punës.

Fndet për shpenzime korente të këtij programi janë planifikuar 5 miliard 36 milion lekë ose 90% e shpenzimeve për këtë program buxhetor. Fondet e buxhetit në këtë program detajohet për 38 DAR/ZA dhe dy institucione nacionale, si Agjencia Kombëtare e Provimeve Tiranë (AKP).

Realizimi 12-mujor është në masën **5 miliard e 3 milion lekë ose 99 %**

**Fondet “për shpenzime personeli” ku përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore, janë 4 miliard e 828 milion lekë** për 5,808 punonjës nga të cilët 5,121 punonjës mësimore dhe 687 punonjës ndihmës për shërbime mbështetëse, për rreth 111 086 nxënësve në arsimin e mesëm (gjimnazet) , realizimi 12-mujor është në masën **4 miliard e 798 milion lekë ose 99 %**

**Shpenzime operative** në artikullin **602- 606, janë planifikuar 207.6 milion lekë ose 4.2%** e shpenzimeve korente, realizimi i shpenzimeve për periudhën 12- mujore është në masën **204.7 milion lekë ose 99%** ku përfshihen;

- ✓ Shpenzime për DAR/ZA shpenzime për transportin e mësuesve dhe për blerje mjetet didaktike e materiale te tjera mësimore ne vleren **80 milion lekë,**
- ✓ Shpenzime për trajnime personeli e të ngjashme – **20 milion lekë,**
- ✓ Shpenzime për AKP - **40** milion lekë, shpenzime për aktivitete për maturën shtetërore
- ✓ Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor, **3 milion lekë,** (për tu paguar në vitin 2014 për mungësë fondesh nuk janë likujduar)
- ✓ Shpenzime për të mbuluar aktivitete ekstrakurrikulare, olimpiada kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca në MAS, **1 milion lekë**
- ✓ Shpenzime për vleresimi i teksteve shkollore si dhe veprimtaria e BOMIT 2012-2013 libri shkollor, **2 milion lekë,** (për tu paguar në vitin 2014 për mungësë fondesh nuk janë likujduar)
- ✓ **Shpenzime për në artikullin 606, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale 78.3 milion lekë,** ku kane perfituar ribursim rreth 18 644 nxnës.

**Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimi Mesem te Pergjithshëm, janë 512 milion lekë,** nga të cilat :

- a) 466 milion lekë financim i brendshëm ose 91%
- b) 46 milion lekë financim të huaj ose 9%

Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12 mujorin 2013 në këtë program është rreth 490.8 milion leke ose 96%, sipas projekteve kryesore paraqiten:

Investime pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve 2012-2013 në shumën prej rreth 377 milion lekë për objektet në vazhdim dhe objekte të reja të miratuara me FZHR 2013.

- U financuan 8 objekte ndërtim të reja me vlerë rreth 144.5 milion lekë realizuar rreth 105 milion lekë ose 73%,
- U financuan 21 rikonstruksione objektësh arsimore me vlere rreth 227.5 milion lekë realizuar 225.5 milion lekë ose 100%,
- U financuan 30 milion lekë për pajisje mobilerie të realizuara 100%.

Investime në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë financimi gjithsej 146.2 milion lekë.

- Ndërtim të reja 3 objekte shkollore në vazhdim nga viti 2012 në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë financimi 65 milion lekë, realizimi 100%.
- Pajisje mobilje për 3 shkollat e reja në vazhdim nga viti 2012, në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë prej 9.5 milion lekë, realizuar 100%.
- Pajisje kompjuterike – 20.4 milion lekë në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim, realizuar 15.8 milion leke.
- Kabinete informatike të pajisura me lidhje interneti - 45.8 milion lekë, **nuk ka realizim**.
- Pajisje laboratorike kimie, fizike, biologji – 5.5 milion lekë realizuar 3 milion lekë .
- Tvsh e financuar për projektet e PNUD-it, (1 rikonstruksion shkolle e mesme) – 8.8 milion lekë, realizuar 100% .
- Pajisje bllokues/zhurmues i sinjalit telefonik mobil në ambientet e provimit të maturës shtetërore – 19.8 milion lekë, realizuar 16.3 milion leke .

Realizimi i fondeve buxhetore për **12- mujin 2013**, në këtë program është në masën 5 miliard e 493 milion lekë ose në masën 99 % të planit vjetor dhe përfaqëson rreth 13.8% të totalit fondeve të planifikuara për MAS dhe 14.2% të fondeve të realizuara për MAS.

Shpenzimet korente	<b>99%</b>
<b>Shpenzimet kapitale</b>	<b>96 %</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>99%</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet në tabelën në vijim:

Kodi i Produkti	Emri i Produktit	Buxheti Vjetor 2013	Buxheti Vjetor Rishikuar 2013	Fakti 12-mujor 2013	Realizim 12-mujor në %
A	Shkolla të pajisura me laboratore shkencore	5,500.0	4,000.0	2,998.2	75%
A	Laboratore IT të pajisura me kompjutera në AMP.	40,308.4	39,308.4	30,248.1	77%
A	Shkolla/ klasa të pajisura me mobilerie	9,500.0	39,500.0	39,471.6	100%
A	Shkolla në arsimin e mesëm të reabilituara/zgjeruara	179,182.3	245,511.0	234,563.8	96%
A	Shkolla të reja të ndërtuara sipas standardeve europiane	309,688.0	164,519.8	163,239.0	99%
I	Instalimi i shërbimit të internetit	45,821.3	20,000.0	20,000.0	100%
A	Rritja e mëtejshme e cilësisë së mësimdhënies, me qëllim që, deri në vitin 2016 të përfrohet standardet e vendeve të BE.	4,567,509.0	4,851,305.3	4,832,312.1	100%
B	Sigurimi i teksteve shkollore për nxënësit e arsimit të mesëm të përgjithshëm.	68,000.0	84,151	82,475	98%
C	Zhvillimi i kurrikulave të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm. Realizimi i proceseve teknike dhe ligjore për hartimin e kurrikulave si dhe miratimi i këtyre standardeve dhe kurrikulave.	35,632.0	0.0	0	0
D	Krijimi i kushteve për realizimin e maturës shtetërore, hartimi i testeve për provimeve, procesi i dhenies së provimeve, vlerësimeve të provimeve deri në shpalljen e rezultateve	91,102.0	88,656.3	88,238	100%
E	Trajnimi i 15-20% e punonjësve mësimorë, për zbatimin e kurikulës së gjimnazit.	12,105.0	12,105.0	0	
<b>TOTALI</b>		<b>5,364,348</b>	<b>5,549,057</b>	<b>5,493,546</b>	<b>99%</b>

**Nga sa me sipër, disa produkte nuk janë realizuar;**

1. Instalimi i shërbimit të internetit. (nuk është realizuar me sukses kontrata e lidhur),

**Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12-mujorit 2013:**

1. Shpërndarja me vonësë e detyrimeve nga fondi i zhvillimit të rajoneve për investime për vitin 2013 me përfitues njësitë e pushtetit vendor.

2. Vonesat në disbursimin e fondeve me burim financimin e huaj në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, nga bankat donatore.

#### **IV - ARSIMI I MESËM PROFESIONAL (Titulli i programit 09240).**

Fondet e buxhetit të rishikuara për vitin 2013 për këtë program janë në masën **2 miliard e 359 milion lekë** dhe zë 6.1% të buxhetit të MAS, realizimi i shpenzimeve për 12- mujin 2013 është në masën **2 miliard e 274.2 milion lekë** ose 96 % e planit vjetor, rreth 6% të shpenzimeve të realizuara të MAS

##### ***Objektivat kryesorë për vitin 2013,***

1. Të regjistrohen 25% nga totali i nxënësve që regjistrohen në arsimin e mesëm. Rritja e regjistrimeve në klasën e X të me 8-10% ndaj vitit paraardhës.
2. Oferta e profesioneve të përputhet me kërkesat e tregut, vlerësuar me rritje 5 % e nxënësve të punësuar, (mbas 6 muajsh të përfundimit të shkollës) për çdo vit të PBA. Kjo bëhet e mundur edhe me përfundimin e pilotimit dhe masivizimit të modulit Moodle (pjesë e portalit të AP), ku nxënësit dhe mësuesit shkëmbejnë eksperiencë, materiale mësimore, etj.
3. Rritja e numrit të nxënësve edhe nga zonat rurale të vendit duke i mbështetur me politika favorizuese e sociale. Favorizimi i nxënësve në nevojë dhe sidomos për ato në degët Bujqësi, Blegtori e Ndërtim, gjeologji dhe teknik përmes dhënies së 1600-1650 bursave të reja për çdo vit të PBA.
4. Rritja e cilësisë së mësimdhënies nxënies dhe kushteve të shkollave e konvikteve (përfitues afro 20 000 nxënës), përmes pajisjes së 3 shkollave me Lab. digjitale të gjuhëve të huaja, 5 shkollave me Lab. virtual, instalimit të 5 Lab. Kimi-biologji, Fizike dhe Informatike; krijimit të 4 kab. të reja Elektroteknike, Mekanike; pajisjes së 4 shkollave artistike me mjete pune, etj; dhe tërheqjes dhe kualifikimit të mësuesve e specialisteve të kualifikuar.
5. Akreditimi i 5 shkollave dhe përputhja e kurrikulave me Kornizën europiane të kualifikimeve, përmes rishikimit të 50 skelet-kurrikulave profesionale për klasat 2, 3, 4 dhe i skelet-kurrikulave të reja prof. e social-kulturorë për klasat 2, 3, 4; Hartimi i 10 programeve për lëndët profesionale e social kulturorë.
6. Mbështetje financiare për nxënësit (rreth 2 260), që kryejnë praktika profesionale në biznes.
7. Mbështetje financiare për kompletimin e nxënësve me Tekste e Manualëve të praktikave me kurrikula në përputhje me nivelin e pestë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

##### **Arritje 2013**

1. Modernizimi i arsimit profesional është prioriteti numër një i Ministrisë për vitin akademik 2013. Reforma në këtë sistem synon të përshtatë programet dhe degët e shkollave profesionale në funksion të kërkesave të ekonomisë dhe tregut të punës.
2. Rritja e % numri i nxënësve të regjistruar në vitin e parë të arsimit të mesëm profesional në krahasim me një vit më parë, si rrjedhojë e hapjes së degëve dhe profileve të reja si ato të IT, agro-përpunimit, bujqësisë e ushqimit, turizmit dhe shërbimeve; përfundimi i ndërtimit të 4 shkollave të reja me kapacitet 700-800 nxënës secila si dhe pajisja e tyre me laboratorë, ngritjes së një sistemi modern të informimit të nxënësve të arsimit të detyruar dhe prindërve të tyre si dhe një sërë projekteve mbështetëse të qeverive të vendeve mike.
3. Transformimi i shkollave profesionale në qendra të hapura gjatë gjithë ditës, ku do të mësojnë jo vetëm nxënësit e rregullt, por edhe të rinj, të cilët, për shkaqe të ndryshme, kanë filluar të punojnë, si dhe të rriturit që dëshirojnë të formohen në një profesion. Reformimi i arsimit profesional do të jetë prioriteti kryesor i ministrisë në kuadër të programit IPA të BE-së.
4. Rritja e ofertave të kurrikulave dhe profileve në shkollat profesionale që reflektojnë kërkesat në tregun e punës, investimet në arsimin profesional kryesisht në rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin drejtimin tekniko-profesional, rritjen e cilësisë dhe modernizimin e infrastrukturës fizike dhe laboratorike (punishtet për mësim praktik) në shkollat profesionale.
5. Përfundimi për rindërtimin e 5 shkollave profesionale me fondet e Bashkimit Europian (IPA), si dhe vijimi i punës për ndërhyrjen/rikonstrukcionin dhe në 2 shkolla të tjera. Vijnë procedurat për pajisjen e 8 shkollave profesionale me fondet e Bashkimit Europian (IPA) si dhe fonde të buxhetit të shtetit.

6. Vijon mbështetja me bursa reth 3500- 4000 nxënësve që ndjekin shkollat profesionale në degët bujqësi, ndërtim dhe pyje, si dhe mbështetja me prioritet për të gjithë nxënësit konviktore të vijnë nga 16 rrethe të zonave verilindore dhe juglindore të vendit dhe ndjekin shkollat profesionale.
7. Tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit e komunitetit romë dhe rimbursim 100% për nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale, për vitin 2013 përfituar kompesim financiar rreth 1500 nxënës me vlerë rreth
8. Mbështetjen financiare nga projekti i Qeverisë së Konfederatës të Zvicrës, faza e tretë e projektit “Mbështetje për Arsim dhe Formim Profesional Shqiptar me fokus profilin e Termohidraulikës dhe IT”.
9. Janë hartuar 3 Skeletkurrikula të niv. II, janë hartuar 2 Skeletkurrikula të niv. III, janë rishikuar 2 Skeletkurrikula që janë në zbatim, është hartuar Moduli pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike”, është hartuar Materiali mësimor për Modulin pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike”, janë përgatitur 3 paketa mësimore mbështetëse (120 fq. A4) për zbatimin e lëndëve dhe moduleve profesionale të AP.
10. Janë hartuar 30 përshkrime të profesioneve të katër niveleve të kompetencës, janë hartuar 3 përshkrime të kualifikimeve të niv. II, (hartimi i një prej të cilave është financuar nga projekti PEM), - janë hartuar i 2 Përshkrimeve të kualifikimeve të niv. III.
11. Eshtë kryer monitorimi i zbatimit të Skeletkurrikulave të AP dhe marrja e fidbekut në 15 shkolla profesionale të vendit. Janë realizuar kontakte dhe udhëzime për drejtues, dhe mësues të shkollave profesionale për zbatimin e Skeletkurrikulave të AP. Janë dhënë kontribute për hartimin e 2 teksteve mësimore për lëndët e shkollave profesionale. Eshtë kryer trajnim didaktik i mësuesve që trajtojnë Modulin pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike. Eshtë dhënë kontribut profesional në të gjitha angazhimit e kërkuara nga MASH dhe MMSR për aspekte të ndryshme të AFP. Eshtë dhënë kontribut profesional në kuadrin e bashkëpunimit me sektorët e tjerë të AKAFPK (programe orientuese për provimet, përshkruesa kualifikimesh etj.) dhe me Institucione të tjera (IZHA, AKP, IKAP etj.). Eshtë dhënë kontribut profesional në grupet e ngritura nga projektet e ndryshme, si IPA-ILO, Projekti ALBIZ (K-education), AlbVET (Seïsscontact), “Mbështetja e AP në Shqipërinë Veri-Lindore” (GIZ) etj. U krye një monitorim i zbatimit të të nxënësve me projekte në profilin “Instalues termohidraulik”, mbështetur nga Programi AlbVET, si dhe u përgatit e prezantua raporti përkatës. Janë kryer veprimtari të drejtpërdrejta udhëzuese dhe trajnuese për PASO-t në kuadrin e bashkëpunimit me ALBIZ. Janë dhënë kontribute për realizimin e konkursit të nxënësve në profilin “Kopshtari”, në kuadrin e bashkëpunimit me MEGATEK. Eshtë dhënë kontribut profesional (prezantime, diskutime, përgatitje materiale etj.) në kuadrin e pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (konferenca, takime, ëorkshope etj.). Janë kryer veprimtari vet-trajnuese (brenda sektorit), trajnuese dhe pjesëmarrje në vizita studimor.

**Shpenzime korrente** të planifikuara për vitin 2013 janë **2 miliard e 2 milion lekë** dhe realizimi vjetor i shpenzimeve korrente për periudhën 12-mujore 2013, është në masën **1 miliard e 929 milion leke ose 96%** e planit vjetor. Fondet buxhetore për programin e arsimit profesional janë detajuar për 13 DAR, 10 ZA dhe 46 shkolla profesionale e socialkulturore, si dhe 30 njësi të qeverisjes vendore.

**Shpenzime për personelin, ”pagat dhe sigurimet shoqërore (artikulli 600/601)”** janë planifikuar 1 miliard e 735 milion lekë ose 73.4% e planit, për rreth 2, 226 punonjës ( nga të cilët 1581 punonjës mësimorë dhe 645 punonjës për shërbime mbështetëse, realizimi është në masën **1 miliard e 707 milion lekë ose 98%** e planit vjetor.

**Fondet e planifikuara në grupin e shpenzimeve korrente për periudhën 12-mujore** janë në masën 266.8 milion lekë , realizimi është në masën 84% ndaj planit vjetor, ku përfitues janë rreth **25 846** nxënës.

1. **Buxheti është detajuar** për shkollat profesionale e social kulturore nacionale, DAR/ZA dhe Aparati i MAS për blerje materiale dhe mjete didaktike 120.1 milion lekë,
2. Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Tirane 6.5 milion lekë realizimi është 4.4 milion lekë ose në masën 68%;
3. Shpenzime për kuota ushqimore bursat e nxënësve për afro 3500-4200 nxënësve janë planifikuar 141.4 milion lekë realizimi për periudhën 12-mujore është 135.6 milion lekë ose rreth 96% ndaj planit vjetor 2013.



4. Për DAR Shkodër bursat për 84 nxënës të shkollës Austriake "Peter Mahringer" Shkodër rreth 8.2 milion lekë janë realizuar në masën 8.2 milion lekë ose 100% kundrejt planit 2013.
5. Shpenzime për në artikullin 606, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për rreth 1500 mijë nxënës janë planifikuar 6 milion lekë realizimi është në masën 5.5 milion lekë ose 90%.

**Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimit Profesional, janë 358 milion lekë, nga të cilat :**

- a) 180 milion lekë financim i brendshëm ose 51%
- b) 178 milion lekë financim të huaj ose 49%

Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12-mujorin e parë 2013 në këtë program është rreth 345 milion leke ose 96% e planit të miratuar, sipas projekteve kryesore paraqiten:

1. Ndërtim konvikti për shkollat profesionale – 49.8 milion lekë, realizuar 100%.
2. Rikonstruksione për shkollat profesionale – 12.6 milion lekë, realizuar 9.7 milion ose 77%.
3. Kabinete informatike ( detyrim nga viti 2012) - 5.9 milion leke, realizuar 100%.
4. Pajisje teknologjike për konviktet – 8.5 milion leke, **nuk ka realizim** .
5. Financim i TVSH për ndërtim dhe rikonstruksion objektsh shkollorë të arsimit profesional nga projektet IPA 2008 – 70 milion lekë, realizuar 68.3 milion leke.
6. Financim i huaj për ndërtim dhe rikonstruksion objektsh shkollorë të arsimit profesional nga projektet IPA 2008 – 178 milion lekë, i cili menaxhohet nga Delegacioni Europian, realizuar 178 milion lekë.
7. Pajisje laboratorike profesionale – 33.2 milion leke, financim i huaj, realizuar 33.2 milion lekë, menaxhohet nga donatorët.

Realizimi i fonde për programe arsimi profesional për 12- mujorin 2013 është në masën **1 miliard e 647.4 milion lekë** ose 69 % e planit vjetor, rreth 5.7% të shpenzimeve të realizuara të MAS

Krahasuar me planin vjetor sipas grup artikujve rezultojnë si më poshtë:

Shpenzimet korente	73 %
<u>Shpenzimet kapitale</u>	<u>47 %</u>
<b>Gjithsej</b>	<b>68 %.</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2013	Buxheti i Rishikuar 2013	Fakti 9-mujor 2013	Realizimi 9-mujor %
A	Laboratore mesimore te lendeve profesionale	72,000.0	42,000.0	7,198.8	17%
I	Blerje pajisje per krijimin laboratoreve te lendeve profesionale ne AMP (mbeshtetje prog IPA)	28,500.0	28,500.0	20,000.0	70%
J	Blerje pajisje elektronike per Krijimi i laboratoreve te infomatikes per AP.	25,883.5	25,883.5	5,883.5	23%
K	Ndërtimi i shkollave Programi IPA (BE), per ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave Profesionale.	270,000.0	270,000.0	120,160.6	45%
L	Reabilitimi objekteve ne shkolla profesionale	7,822.8	7,822.8	7,778.2	99%
M	<b>Ndërtim konvikti</b>	15,793.7	45,793.7	45,793.7	0%
O	<b>Pajisje per konviktet dhe Kuzhinat ne AP.</b>	20,000.0	0.0	0.0	0%
A	Rritja e numrit të nxënësve edhe nga zonat rurale te vendit duke i mbështetur me politika favorizuese e sociale. Favorizimi i nxënësve në nevojë dhe sidomos në degët Bujqësi, Blegtori e Ndërtim, përmes dhënies së 1600 bursave të reja për çdo vit	166,236.0	148,349.0	113,719.0	77%
B	Rritja e cilesise se mesimdhënies, realizimi i shërbimit arsimor, krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsim cilësor, masiv dhe bashkëkohor, mirëmenaxhim të burimeve njerzore, fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollorë	1,769,832.0	1,783,800.2	1,299,204.9	73%
C	Rishikimi i kurrikulave konform Kornizës Europiane të Kualifikimeve	20,465.0	24,046.0	16,190.0	67%
D	Akreditimi i shkollave dhe përputhja e kurrikulave me Kornizën europiane te kualifikimeve	2,500.0	2,500.0	1,680.0	67%

E	Trajnimi cdo vit 15-20% e punonjesve mesimore, per kurrikulat e reja ne AFP dhe zhvillimin profesional	3,750.0	3,750.0	0.0	0%
F	Tekste te integruara per lendet profesionale	17,882.0	21,596.0	9,746.0	45%
		<b>2,420,665.0</b>	<b>2,404,041.2</b>	<b>1,647,354.7</b>	<b>69%</b>

**Nga tabela e mësipërme evidentohet se disa produkte nuk janë realizuar;**

1. Per fondin e pajisjeve teknologjike jane kryer procedurat e prokurimit, lidhja e kontrates, por ka mangësi dokumentacioni për kryerjen e pagesave.
2. Fondi i planifikuar për tvsh nuk është realizuar për mosparaqitje të dokumentacionit të saktë.
3. Menaxhimi i fondeve me burim financimin e huaj në kuadër të projektit IPA, si dhe projektet me Qeverine Zvicerane per projekte pajisjesh per shkollat profesionale behet nga vete donatoret.

**V - INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. (Titulli i programit 09450)**

Fondet buxhetore të planifikuar në programin e arsimit të lartë për vitin 2013 janë **8 miliard e 877.2 milion lekë**, realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2013 në këtë program është në shumën **5 miliard e 833 milion lekë ose 99%** e shpenzimeve të planifikuara. Shpenzimet e buxhetit te arsimit të lartë zënë 15.2% të buxheti të MAS dhe 15.3% të shpenzimeve të realizuara të MAS.

Së bashku me të ardhurat në IAL publike realizmi arrin në vlerën e në **10.1 miliard lekë** realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2013 **është 10. miliard lekë ose në masën 99%**.

**Objektivat kryesorë**

**Objektiv 1.** Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog, përmirësimin e metodave te mësimdhënies, rritjen e numrit të pedagogëve me 300, rritjen e numrit të laboratoreve shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre, duke rikonstruktuar e ngritur godina te reja per 15 000 studente;

**Objektiv 2.** Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit, dhe implementimi i sistemit te krediteve për studentët e IAL-ve bazuar në kualifikimin standart të sistemit të Bolonjës. Sigurimi i cilësisë në shërbimet që ofrojnë IAL përmes vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

**Objektiv 3.** Zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë (AL) përmes: hapjes së rreth 30 kurrikulave të reja të MP/Msc dhe 10 programeve studimi me profile përkatëse të studimeve të Doktoratës, shtimit të studentëve në fushëne e teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë me 13%; shtimin me 5% te numrit studentëve në ciklin e dyte.

**Objektiv 4.** Rritja e autonomisë së IAL përmes, sigurimit të autonomise akademike, strukturore, administrative dhe financiare. Diversifikim të burimeve të financimit, me qëllim optimizimin e investimit publik dhe privat në AL, në funksion të arritjes së objektivave të përgjithshme të AL. (vlerësuar me rritje të ardhurave në % ndaj PBB ose GDP për AL)

**Objektiv 5.** Përgatija e kuadrit ligjor dhe institucional për implementimin e reformës finaciare në AL (formula e finacimit, kredia studentore 2013-2015). Realizimi i politikave të përfshirjes sociale dhe aksesit të gjërë në AL nëpërmjet skemës së kredidhënies studentore dhe mbeshtetjes financiare për përmirësimin e kushteve në shtëpitë e studentëve.

**Arritje në vitin akademik 2013**

Për vitin akademik, 2013-2014, numri i pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ka shënuar një rritje prej 7% të pranimeve. Janë hapur deri tani në ciklin I-rë 334 programe nga 303 që ishin në viti 2012-2013 , ciklin II-të 223 mastera shkencorë ( nga 206) dhe 175 mastera profesionalë (nga 165). Miratimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2013-2014 ka sjellë diversifikim dhe rritje të drejtimit të reja të studimeve.

- ✓ Në të gjitha institucionet e arsimit të lartë (IAL) shtimi i programeve të studimit është shoqëruar me shtimin e kuotave të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit me rreth 6700- 8000 studentë më shumë, ose 7% më shumë se viti i kaluar akademik, ku pranimet e reja në sektorin e arsimit të lartë privat zënë rreth 9%.
- ✓ Zgjerimi i sistemit të arsimit të lartë publik dhe zhvillimi i shpejtë i atij privat kanë çuar në një rritje mbi dy herë të numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe angazhimin e një numri shumë të madh specialistësh dhe ekspertësh të fushave të ndryshme si pedagogë me kohë të pjesshme në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë. Në vitin akademik ishin 4140 pedagogë ndërsa në këtë vit akademik janë rreth 10 600

pedagogë me kohë të plotë dhe të pjesshme, çka flet qartë për një zhvillim shumë premtues të burimeve njëzëzore me nivel të lartë kualifikimi në vend, nëse konsiderojmë faktin që mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në arsimin e lartë janë një faktor shumë i fuqishëm zhvillimi edhe për vetë individët që zhvillojnë një veprimtari të tillë.

- ✓ Në vitin akademik 2012 -2013 u regjistruan në shkollat e larta rreth 72% e atyre që përfunduan me sukses të gjitha provimet e maturës shtetërore. Kjo është një tregues për mundësitë e integritit të brezit të ri në shoqërinë e përfuturit të dijeve, me synimin e krijimit të një ekonomie dhe shoqërie të mbështetur në dije.
- ✓ Në vitin 2020 në Bashkimin Europian, 35 % e vendeve të punës do të kërkojnë arsim të lartë. Universitetet publike të vendit tonë ofruan **60 mijë kuota studimi** në të gjitha ciklet (bachelor, master, doktoratë) dhe të dy format (me kohë të plotë dhe të pjesshme, ku rreth **40 %** ishin të orientuara në shkencat teknike, IT, shkenca natyrore, ekonomi, turizëm, shërbime, bujqësi, etj.
- ✓ Zhvillimi i shpejtë i arsimit të lartë privat ka luajtur një rol të pamohueshëm në rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë. Investimet e shkëlqyera private të bëra në infrastrukturë kanë krijuar një potencial shumë të vyer për shkollimin e të rinjve. Ai mund të bëhet eficient vetëm përmes krijimit të një trupe profesorësh të një niveli të lartë akademik që konkurron denjësisht në hapësirën e arsimit të lartë dhe përbën garantin kryesor dhe afatgjatë të cilësisë dhe të vendit që do të zë cdo IAL në sistemin tonë të AL. Shumë IAL private kanë ndërmarrë hapa serioze në këtë drejtim. Kjo duhet të ndiqet edhe nga IAL e tjera.
- ✓ Sistemi i sigurimit të cilësisë në AL është fuqizuar dukshëm. Angazhimi i ekspertëve të huaj si vlerësues në terren dhe si antarë të Këshillit të Akreditimit ishte një hap shumë i rëndësishëm për fuqizimin e Agjencisë dhe Këshillit të Akreditimit dhe njohjen e tyre të plotë nga Strukturat internacionale të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu janë fuqizuar njësitë e mbikqyrjes së cilësisë dhe inspektimit brenda MAS dhe në APAAL. IKAP, në vitin e dytë të veprimtarisë së tij, shënoi hapa të rëndësishme të konsolidimit të tij. Roli i tij është tashmë shumë i ndjeshëm në sistemin e arsimit parauniversitar.

Gjatë vitit 2013 në Këshillin e Akreditimit janë shqyrtuar;

1. **Për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin;** Vlerësimi i jashtëm institucional 7, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të parë 62, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të dytë 66, vlerësimi i jashtëm i programeve të cilit të tretë 2.
2. **Për vlerësimin paraprak të programeve të reja të studimit:** vlerësimi paraprak i programeve të ri të studimit dyvjeçar 0, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të parë 53, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të dytë 111, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të cilit të tretë 7,
3. **Vlerësimin e dokumentacionit për hapjen e njërive:** Hapje fakulteti 4, riorganizim fakulteti 10, Ndryshim statusi i IAL 1,
4. **Vlerësimi i programeve të studimit pas plotësimit të kushteve:** Vlerësimi paraprak i programeve të ri të studimit dyvjeçar 1, Vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të parë 1, Vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të dytë 4.

Në Agjencinë Kombëtare të Provimeve po ndërtohet Baza Elektronike e të dhënave të arsimit të lartë, që përfshin *Regjistrin Kombëtar të Studentëve*, ku çdo student i regjistruar në cdo shkollë të lartë, publike apo private, që nga viti akademik 2011-2012, në të tri ciklet e studimeve universitare do të ketë numrin kombëtar të identifikimit, përveç atij që ka marrë në universitetin ku studjon

Gjatë vitit 2013, në kudër të marrëveshjeve bilaterale e shkëmbimit të studentëve e kërkuesve të rinj është realizuar regjistrimi i 6 studentëve kinezë pranë Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës dhe trajtimit të tyre me bursë, viti akademik 2013-2014;

Gjatë vitit 2013, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin Histori-Filologji, në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe me shtete të ndryshme organizimi i kursit të verës të gjuhës dhe kulturës shqipe, ku marin pjesë studentë dhe pedagogë të huaj rreth 30 studentë nga Fedarata Ruse.

**Gjatë vitit 2013 nga sektori janë proceduar rreth 1900** diploma universitare të lëshuar jashtë vendit. Për 1688 prej të cilave është përfunduar procedura e njohjes dhe njësitit. Ndërsa rreth 200 të tjera janë në process njohjeje.

Pwr vitin 2013 fondet e buxheti janw detajuar në 13 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, dhe tre institucione të sistemit të arsimit të lartë, për afro 140 mijë studentë në drejtime të ndryshme studimi.

**Buxheti i shpenzimet korrente** për vitin 2013, i planifikuar në shumën 5 miliard e 222.3 milion lekë për periudhën 12- mujore është realizuar në masën 99% ose 5 miliard 190 milion lekë, së bashku me të ardhura plani e rishikaur i grupit të shpenzimeve korente është 8 miliard 484.3 milion lekë ose 88% ndaj parashikimt 9-mujor.

**Shpenzimet për zërin “pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve në artikullin 600/601”** janë planifikuar 4 miliard 717.3 milion lekë milion lekë për punonjesit e 13 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, si dhe tre institucioneve Agjensia e Akreditimit Tiranë, Klubi Sportiv Studenti, Tiranë, si dhe Qendra e shërbimeve të rrjetit telematik Tiranë, së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publik realizimi për periudhën 9-mujore është në masën 85% ose 4 miliard e 529 milion lekë nga 5 miliard e 314 milion lekë të parashikuara për këtë periudhë nga të cilat nga fone të buxheti janë planifikuar 4 miliard 717.3 milion lekë dhe pjesa tjetër janë nga të ardhurat.

**Fondet për universitetet janë rialokuar në formën e grantit të pakushtëzuar.** Universitetet nëpërmjet organeve kolegjiale detajojnë këtë grant sipas njësive shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit për shpenzime pësoneli paga dhe sigurimet shoqërore të punonjësve **4 miliard 356** milion lekë ose rreth **96.66%** e transfertës së pakushtëzuar, realizimi i tyre është në masën 4 miliard e 356 milion lekëve ose 100% ndaj planit.

**Shpenzimet operative** artikulli **602-606** .ku përfshihen shpenzimet e funksionimit janë **945.2** milion lekë dhe realizimi është në masën 607.4 milion lekë ose 64%, **nga të cilat**

- ✓ **Për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL)**, kapitulli 01 ,07 dhe 08, artikulli 602 shuma e planifikuar prej **72 milion lekë** realizimi i shpenzimeve me burim nga buxheti i shtetit dhe transferata e pakushtëzuar është në masën 70 milion lekë ose 98% e planit 2013.
- ✓ Aktivitete në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” janë planifikuar 16.5 milion lekë për Agjencinë Kombëtare të Provimeve dhe janë realizuar 9 milion lekë ose 100%.
- ✓ **Shpenzimet për artikullin 603. Subvencionet** të Sh.a “Trajtimi i Studentëve” në Tiranë dhe në rrethe janë **350 milion** lekë për akomodimin 12 000 - 13 000 studentë që akomodohen në mjediset shtëpive të studentëve, realizimi është në masën **350 milion lekë ose 100 %**
- ✓ **Shpenzimet për zërin “Bursat e studentëve në artikullin 606”, janë planifikuar** 469 milion lekë për rreth 8 000 studentë që trajtohen me bursë nga IAL publike realizimi 12- mujor është në masën 465.5 milion lekë ose **99%..**

**Shpenzimet kapitale për këtë program janë 655 milion lekë, nga të cilat :**

- a) 525.7 milion lekë financim i brendshëm ose 80%
- b) 129.3 milion lekë financim të huaj ose 20%

Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12 mujorin e vitit 2013 në këtë program është rreth 643.4 milion lekë ose 98 %, me realizim kryesisht të fondeve nga FZHR 2013, sipas projekteve kryesore paraqiten:

1. Fondi për zhvillimin rajonal 2013 prej 500 milion lekë për ndërtime të reja dhe rikonstruksione nga FZHR, realizuar me 497.6 milion leke.
2. Pajisje laborator – kërkimorë e shkencorë – 30 milion lekë në kuadër të projektit ”Cilësi dhe Barazi në Arsim”, realizuar 12.2 milion lekë.
3. Pajisje laboratorike per Akademinë e Arteve Shkoder 1.5 milion leke , nuk ka realizim
4. Financimi për tvsh për projektet e huaja në arsimin e lartë - 10 milion lekë, realizuar 336 mije leke.
5. Projekti me qeverine italiane per krijimin e qendres informacionit kerkimit dhe zhvillimit – 129 milion lekë, realizuar rreth 129 milion lekë ose 100%
- 6.

Në këtë program janë parashikuar për t’u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet ne tabelë:

Kod Produkt	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2013	Buxheti i Rishikuar 2013	Fakti 12-mujor 2013	Realizimi 12 mujor % ndaj planit vjetor 2013

A	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, rritjen e numrit të pedagogëve me 300	4,202,502.0	4,369,962.2	4,343,702.7	99.4%
B	Përgatitja e kuadrit ligjor dhe institucional për implementimin e reformës financiare në AL (formula e financimit, kredia studentore 2013-2015).	16,500.0	7,115.2	5,996	<b>84.3%</b>
C	Vleresime dhe akreditime të IAL, për një proces çilesor të sigurimit të cilësisë	19,740.0	16,690.0	<b>15,717</b>	94.2%
D	Mbështetje financiare për studentet që studiojnë në IAL publike,	771,110.0	819,524	815,267	99.5%
K	Të sigurohet cilësia e programeve të studimit, dhe implementimi i sistemit të krediteve për studentet e IAL-ve bazuar në kualifikimin standart të Bolonjës.	86,628.0	9,000.0	9,000	100.0%
L	Perkthimi i teksteve e botime për studentet në IAL-eve të gjitha programeve të tyre të studimit në ciklin e parë.	50,000.0	<b>0.0</b>	0	0.0%
A	Krijimi i laboratoreve të Informatikës IT, si rrjeti i telematik nderuniversitar.	458,397	135,692	130,097	95.9%
E	Krijimi i laboratoreve teknologjike dhe me karakter teknik në IAL.	11,603	8,510	3,398	39.9%
F	Krijimi i laboratoreve kerkimore e shkencore me pajisje të standarteve bashkohore.(CBA).	130,000	13,041	12,208	93.6%
G	Ndertime të reja për shtimin e kapaciteteve si dhe përmirësimin e standarteve në IAL	325,829	276,036	276,036	100.0%
H	Reabilitimi i godinave ekzistuese për shtimin e kapaciteteve si dhe përmirësimin e standarteve të akomodimit në IAL. zgjerimi i sistemit të IAL me drejtime të reja studimi si dhe plotësimi i tre cikleve të studimit.	174,171	221,656	221,639	100.0%
		<b>6,246,480</b>	<b>5,877,226</b>	<b>5,833,061</b>	99.2%
	<b>Shpenzime jashtë buxhetore</b>		4,200,416	4,186,478	99.7%
		<b>6,246,480</b>	<b>10,077,641</b>	<b>10,019,540</b>	99.4%

**Nga tabela e mësipërme evidentohet se disa produkte nuk janë realizuar;**

1. Krijimi i laboratoreve të Informatikës IT, si rrjeti i telematik nderuniversitar.( procedurat janë në vijim)
2. Krijimi i laboratoreve teknologjike dhe me karakter teknik në IAL.
3. Perkthimi i teksteve e botime për studentet në IAL-eve të gjitha programeve të tyre të studimit në ciklin e parë, produkt i realizuar me të ardhurat dytësore të IAL

**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12 mujorin e vitit 2013:**

1. Në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, nuk është realizuar një aktivitet i celur si pasojë e mosrealizimit të procedurës së prokurimit.
2. Projekti për ngritjen dhe zhvillimin Qendrën e Rrjetit Telematik të IAL, investim i Qeverisë Italiane, administrimi dhe menaxhimi i fondeve me financim të huaj realizohet nga QNRRTSH në banka të nivelit të dytë,
3. Gjithashtu mosçelja e fondeve nga Ministria e Financave **apo mbajtja në “formë të ngrirë”** e një pjese e fondit prej 20 milion lekë të QNRRTSH, ka penguar realizimin në tërësi të gjithë projektit, sipas afateve të përcaktuara në marrëveshjen ligjore.

## **VI - Kërkimi Shkencor. (Titulli buxhetor i programit 09770)**

Fondet për këtë program janë planifikuar në total në vlerën **144.4 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2013** në këtë program është **140.8 milion lekë ose 98 %** dhe përfaqëson rreth 0.4 % të fondeve buxhetit të MAS dhe 0.4% totalit të shpenzimeve të realizuara për 12- mujorin e vitit 2013

### **Objektivat kryesorë**

- ✓ **Objektiv** 1). Rritja dhe zgjerimi i kërkimit shkencor në Shqipëri bazuar në treguesit e OECD,; ku pjesa e shpenzimeve publike për vitin 2013 të arrije 0,3 % të GDP (e perlllogaritur për shpenzimet për kërkim në IAL publike e private, ministritë e linjes, institucione të tjera kerkimore shtetërore dhe biznese).
- ✓ **Objektiv** 2). Mbështetja e institucioneve kërkimore dhe universiteteve për zhvillimin dhe mirembajtjen e infrastrukturës laboratorike kerkimore shkencore(CBA).
- ✓ **Objektiv** 3). Nxitja e punës kerkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtperdrejtë të 2940 kërkuesve, si dhe mbështetjes financiare për kërkim fundamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit, mbështetjes financiare për funksionimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve didaktiko-kërkimorë në IAL publike. (09770.602)
- ✓ **Objektiv** 4). Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit nepermjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL mbi

Programet Kombëtare (AKTI), Bilaterale dhe Programin e Shtatë Kuadër (FP7), Erasmus Mundus, Tempus, etj.

- ✓ **Objektiv 5).** Finalizimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ne fushen e kerkimit dhe teknologjise.
- ✓ **Objektiv 6).** Mbështetja financiare për studentet që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira të botës (Lista Shangai, e FT) dhe doktorantë ekselentë. Mbështetje financiare për programin "Brain Gain"

### **Projekte që mbështeten me financim nga buxheti i shtetit për vitin 2013;**

- ✓ Promovimi i Programeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet Konferencave dhe Seminareve të organizuara nga MAS
- ✓ **Pagesa e kuotës vjtoje për projektet në kuadrin e FP 7,** etj. Në zbatim të ligjin nr. 9866, datë 31.01.2008 "Për ratifikimin memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European, për asocimin e Republikës së Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të Komunitetit European, për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe të veprimtarive të demonstrimit 2007-2013", janë realizuar pagesat për transhin e plotë të 2013. Në këtë program janë përfutuar fonde nga Delegacioni i Bashkimit European në Tiranë rimbursim shpenzimesh për vitin 2012, të cilat janë përdorur për pagësn e kuotës vjtoje për vitin 2013.

### **Arritje 2013**

- ✓ **Fondi i Ekselencës i Qeverisë;**
- ✓ Për vitin akademik 2013-2014, aplikuan pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, 33 **aplikantë të ndërmjetëm (të cilët janë shpallur fitues në vitet akademike paraardhëse)**, për vazhdimin e mbështetjes financiare për kryerjen e studimeve. Në përfundim të fazave përzgjedhëse, u kualifikuan si fitues 30 aplikantë dhe u nënshkruan akt-marrëveshjet.
- ✓ Përfitues për studime universitare jashtë vendit, madje edhe në 15 universitetet më të mira të botës dhe një sërë programesh mbështetëse të BE (Erasmus, **Tempus**, Marie Curie, Jean Monnet, etj) si dhe të vendeve partnere (programet e bursave: Fulbright, DAAD, Aleanca Franceze, Programi i Austrisë, janë 65 studentë.
- ✓ **Programi bilateral me Italinë,** dhe të disa vendeve të tjera në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe) kanë krijuar të gjitha mundësitë për një kualifikim të shpejtë dhe përfitim të përvojës internacionale aq të domosdoshme për përgatitjen e brezit të ri të profesoratit të vendit tonë në nivele dhe standarde të krahasueshme me ato të vendeve të zhvilluara.
- ✓ Nënshkrimi I Memorandumit të Mirëkuptimit të Programit Lifelong Learning LLL Te nxenit gjate gjithë jetes;
- ✓ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe Ludëig-Maximilians-Universitât München për mbështetjen e mësimdhënies dhe të hulumtimit shkencor në degën e studimeve të Albanologjisë;
- ✓ Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë dhe Universitetit Eötvös Loránd, Budapest, për ofrimin e mësimdhënies në disiplinën e gjuhës dhe kulturës shqipe, nënshkruar në Budapest më 20 mars 2012.
- ✓ Realizimi i vizitës së studiuesit grek Stratos Georgoulas nga Universiteti i Egjeut në Universitetin e Elbasanit, në kuadër të programit të bashkëpunimit kulturor ndërmjet RSH-Greqi.
- ✓ **Sfida kryesore në fushën e kërkimit shkencor mbetet rritja e investimit privat në shkencë.**

**Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2013** në këtë program është **140.4 milion lekë ose 98%** e planit vjetor dhe përfaqëson rreth 0.4 % të fondeve buxhetit të MAS ose 0.4% totalit të shpenzimeve të realizuara për 12- mujorin e vitit 2013, së bashku më fondet e realizuara nga të ardhurat e donatorëve si dhe të IAL publike shpenzimet për periudhën 12-mujore janë realizuar në masën 413.9 milion lekë 99% e ndaj planit 2013 me rreth 1% e shpenzimeve të MAS.

Sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzime korente	98%
Shpenzime kapitale	100%
<b>Totali</b>	<b>99 %</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

<b>Kodi i Produktit</b>	<b>Emri i Produktit</b>	<b>Buxheti Plan 2013</b>	<b>Buxheti i Rishikuar 2013</b>	<b>Fakti 12-mujor 2013</b>	<b>Realiz 12-mujor në % 2013</b>
A	Pjesmarrja e Programe Nderkombetare te Bashkepunimit Shkencor e Teknologjik te mbeshtetura financiarisht.	6,120.0	3,834.9	287.0	7%
B	Pjesmarrje me projekte te mbeshtetura financiarisht ne kuader te FP7.	105,000.0	85,000.0	<b>85,000.0</b>	100%
C	Programe Kerkimore Universitare dhe i Shkollave te larta dhe kerkues te rinj te mbeshtetura financiarisht.	0.0	0.0	0.00	0%
D	Mbeshtetje per Projekte te Rendesise se vecante te mbeshtetura financiarisht nga MAS.	4,000.0	0.0	0.0	0%
E	Promovimi i projekteve ne kuadrin e Programeve Kombetare dhe Nderkombetare te Kerkimit dhe Zhvillimit, nepermjet Konferencave dhe Seminareve te organizuara nga MAS	0.0	0.0	0.0	0%
F	Kerkues dhe shkencetare TE rinj qe kryejne studimet e tyre Universitare & sudime doktorature ne 15 universitet me te mira te botes, si programi BRAIN GAIN	150,000.0	55,585.2	55,585.1	100%
	<b>TOTALI</b>	<b>265,120</b>	<b>144,420</b>	<b>140,872.2</b>	<b>98%</b>
	Shpenzime jashte buxhetore Për pjesmarrje me projekte te mbeshtetura financiarisht ne kuader te FP7.	<b>0</b>	<b>273,027</b>	<b>273,027</b>	<b>100%</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>265,120</b>	<b>417,447</b>	<b>413,899</b>	99%